



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI I TIRANËS
FAKULTETI I GJUHËVE TË HUAJA
DEPARTAMENTI I GJUHËS ANGLEZE



PROGRAMI MËSIMOR I LËNDËS
Edukim Ndërkulturor

Ngarkesa: 6 kredite, 40 orë mësimore, 15 leksione dhe 25 seminare

Viti / Semestri : Viti I, sem. II

Lloji i lëndës: Lëndë e detyrueshme

Programi i studimit: Master i Shkencave, ‘‘Mësuesi në Gjuhë Angleze ‘‘

Kodi i Etikës: Kodi i Etikës i Universitetit të Tiranës (Nenet 4, 6, 7, 9)

PËRMBLEDHJE DHE REZULTATET E TË NXËNIT:

Objektivat e përgjithshëm lëndore:

T’u ofrojë studentëve të mësuesisë një kuadër teorik dhe praktik për përfshirjen e elementeve kulturore në mësimdhënien e gjuhës angleze. Të rrisë ndërgjegjësimin për rëndësinë e edukimit ndërkulturor në ndërtimin e marrëdhënieve efektive në klasë dhe shoqëri. Të pajisë studentët me njohuri dhe aftësi për të promovuar diversitetin kulturor dhe për të ndërtuar ura komunikimi në një mjedis shumëkulturor.

Objektivat specifike lëndore:

1. Të zhvillojnë njohuri socio-kulturore mbi normat, vlerat, stilin e jetesës dhe modelet e komunikimit të kulturave të ndryshme.
2. Të trajnohen në përdorimin e mjeteve pedagogjike, metodave dhe teknologjive (TIK) për të nxitur dialogun dhe ndërveprimin ndërkulturor në klasë.
3. Të nxisin reflektimin kritik mbi perceptimet, paragjykimet dhe stereotipet dhe të përvetësojnë strategji për komunikim të efektshëm dhe gjithëpërfshirës.

Rezultatet e pritshme :

1. Studentët do të jenë të aftë të analizojnë dhe të integrojnë përmbajtje kulturore në orën e gjuhës së huaj përmes metodave didaktike të përshtatshme.
2. Do të dinë të vëzhgojnë dhe interpretojnë situata ndërkulturore, të mbështesin gjykime të balancuara dhe të ndërveprojnë në mënyrë konstruktive në mjedise të ndryshme.
3. Do të zotërojnë strategji të sjelljes dhe komunikimit të përshtatshme për të ndërtuar ura bashkëpunimi dhe mirëkuptimi në një kontekst shumëkulturor dhe edukativ.